


AGJENCIA E SHËRBIMEVE TË NAVIGACIONIT AJROR

Gjatë vitit 2017, në ASHNA u realizuan 20060 operime

faqe 4



ASHNA edhe me një certifikatë gjatë vitit 2017

faqe 2

Rreth 600 nxënës vizituan ASHNA-në gjatë vitit 2017

faqe 6



Ministri Lekaj premtoi mbështetje për projektet zhvillimore të ASHNA-së

faqe 3



Menaxhmenti i ASHNA-së miraton Plan-Dokumentet për Vitin 2018

faqe 5



ASHNA priti në një vizitë Ministrin e Punëve të Brendshme z. Flamur Sefaj

faqe 3

Si drejtohet një fluturim sigurt nga Kontrollorët e Trafikut Ajror?

faqe 7

ASHNA Çertifikohet si Organizatë Trajnuese për Kontrollorë të Trafikut Ajror



Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA), u certifikua si Organizatë Trajnuese për Kontrollorë të Trafikut Ajror nga ana e Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës (AACK). Ky certifikim paraqet kurorëzimin e një

procesi të gjatë të angazhimit të ASHNA-së në përmbushjen e kërkesave të paraqitura me rregulloret përkatëse v e n d o r e d h e ndërkombëtare. Pas auditeve dhe bashkëpunimit të afërt, AACK vlerësoi përmbushjen e këtyre


standardeve përmes certifikimit të ASHNA-së si organizatë trajnuese. Në këtë ceremoni rasti, e cila u zhvillua në ambientet e ASHNA-së, Drejtori i AACK-së z.Dritan Gjonbalaj me bashkëpunëtorë i dorëzoi ASHNA-së certifikatën e organizatës

trajnuese dhe përgëzoi menaxhmentin dhe gjithë stafin për rezultatet e arritura. Drejtori i ASHNA-së, Bahri Nuredini gjithashtu falënderoi gjithë punëtorët e ASHNA-së dhe AACK-në për punën dhe përkushtimin e treguar në përmbushjen e kritereve të kërkuara për certifikim si organizatë trajnuese. Ky certifikim është i një rëndësie të madhe jo vetëm për ASHNA-në, por edhe për Kosovën, duke qenë se vendi ynë për herë të parë ka një organizatë trajnuese të certifikuar, për ofrim të shërbimit të disa trajnimeve shumë specifike në fushën e ofrimit të shërbimeve të navigimit ajror. për më shumë, përmes këtij certifikimi mundësohet edhe vlerësimi i kompetencës së kontrollorëve të trafikut nga ana e instruktorëve dhe vlerësuesve të certifikuar të kompetencës të ASHNA-së.



Certifikata e ASHNA-së si Organizatë Trajnuese për Kontrollorë të Trafikut Ajror

Ministri Lekaj premtoi mbështetje për projektet zhvillimore të ASHNA-së



Pamje gjatë takimit të Drejtorit të ASHNA-së Bahri Nuredini dhe Ministrit të Infrastrukturës Pal Lekaj

Drejtori i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA), Bahri Nuredini, me datë 11 Nëntor 2017, priti në një takim Ministrin e Infrastrukturës, Pal Lekaj. Bahri Nuredini e falën-

deroi për vizitën dhe interesimin e Ministrit Lekaj rreth punës së ASHNA-së. Në këtë takim, Drejtori Nuredini, e njoftoi Ministrin Lekaj, me punën dhe mbarëvajtjen e trafi-

kut ajror, projektet zhvillimore duke përfshi edhe normalizimin e hapësirës së ulët ajrore si dhe sfidat me të cilat përballlet ASHNA-ja. Nga ana tjetër Ministri Lekaj u zotua, se minis-

tria që ai drejton, do t'i mbështesë projektet zhvillimore të ASHNA-së, për ngritjen e kapaciteteve të menaxhimit të trafikut ajror në Republikën e Kosovës.

Ministri i MPB-së i dorëzoi Drejtorit të ASHNA-së Programin Kombëtar për Sigurim të Aviacionit Civil



Pamje gjatë vizitës së Ministrit të Punëve të Brendshme Flamur Sefaj në Kullën e Trafikut Ajror

Ministri i Punëve të Brendshme Flamur Sefaj, me bashkëpunëtorë qëndroi për vizitë në

Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA), me datë 14.11.2017, ku u pritë


nga Drejtori i ASHNA-së Bahri Nuredini. Gjatë këtij takimi, drejtori Nuredini, e

njoftoi Ministrin Sefaj, për planet dhe projektet e zhvillimit të ASHNA-së, me theks të veçantë mbi gjendjen e sigurisë në ASHNA.

Ministri Sefaj me këtë rast i dorëzoi Drejtorit Nuredini, "Programin Kombëtar për Sigurim të Aviacionit Civil (Revizioni Nr.04)".

Ministri i MPB-së, në fund vizitoj edhe kullën e trafikut ajror, ku u njoftua më për së afërmi me punën që zhvillohet në ASHNA.

Gjatë vitit 2017, në ASHNA u realizuan 20060 operime



[Totali i operimeve të realizuara në ASHNA gjatë vitit 2017](#)


Gjatë vitit 2017, në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA), janë realizuar gjithsejtë 20060 operime, ku nga totali i këtyre operimeve, 14965 kanë qenë Operime Komerciale, 1191 Operime Ushtarake dhe 3904 kanë qenë Operime

tjera apo VFR. Nga totali i operimeve prej 20060, krahasuar me numrin e operimeve të realizuara gjatë vitit 2016, vërehet një rënie e lehtë prej -2.65%, rënie kjo e cila është reflektuar nga numri i Operimeve Ushtarake dhe VFR, pasi që në Operimet


Komerciale është shënuar ngritje. Ndërkaq nëse i krahasojmë në kategori të operimeve vitin 2017 me vitin 2016, atëherë del se, tek Operimet Komerciale ka një ngritje prej 370 operime më shumë, ose krahasuar në përqindje i bie 2.54%,

kurse tek Operimet Ushtarake vërehet një rënie e numrit të operimeve prej 204 operime më pakë, e që në përqindje i bie -14.62% si dhe operimet tjera apo VFR, tek të cilat po ashtu vërehet një rënie prej 712 operime më pakë, kthyer në përqindje i bie -15.42%, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2016. Kurse sa i përket të dhënave për operime në baza mujore, vetëm gjatë muajit Dhjetor 2017, janë realizuar gjithsejtë 1628 operime.

Nga ana tjetër, nëse marrim për bazë vitet shumë më përpara të realizimit të operimeve, që nga viti 2002 e deri në vitin që lamë pas, pra vitin 2017, janë realizuar gjithsejtë 266823 operime. Vlen të ceket se nga të gjitha këto operime të realizuara nuk ka pas asnjë incident serioz, i cili do të kishte ndikim në sigurinë e operimeve.



[Operimet 2017, krahasueshmëria me operimet 2016](#)



[Operimet Dhjetor 2017, krahasueshmëria Dhjetor 2016](#)

Menaxhmenti i ASHNA-së ka miratuar Plan-Dokumentet për Vitin 2018



Pamje nga takimi i Menaxhmentit të ASHNA-së

Menaxhmenti i (KCSSB), e cila është Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA), në mbledhjen e 9 të Komitetit për Cilësi, Siguri dhe Sigurim

mbajtur me datë 27.12.2017, ka Aprovuar dokumentet përkatësisht plan dokumentet për vitin 2018.

Dokumentet te cilat janë

aprovuar në këtë mbledhje janë:

Plani i Biznesit 2018 - 2022

Plani Vjetor 2018

Plani i Trajnimeve 2018

Plani i Punës 2018

Plani i Pushimeve Vjetore 2018

Plani Preliminar i Prokurimit 2018

E veçanta e këtij viti që ndron tek planifikimi i

investimeve kapitale, ku

në krahasim me vitet

paraprake, për vitin 2018

kemi një buxhet të shtuar për këto investime. Sipas kufijve të aprovuar buxhetor

2018 për projekte kapitale kemi të ndara grante në vlerë prej 1,400,000€ si dhe 2,000,000€ nga fondi i AKP-së.

Shikuar në analizat dhe projeksionet e ASHNA-së, ka nevojë të mjetëve shtesë dhe janë të arsyeshme dhe shumë të domosdoshme. Në aspektin e përgatitjes së infrastrukturës së domosdoshme për menaxhimin e Hapësirës së Lartë Ajrore të Republikës së Kosovës, duhet të theksohet që projektet e përgatitjes së navigacionit ajror janë projekte komplekse dhe kërkojnë kohë më të gjatë për implementimin e tyre, andaj kjo na bënë të jemi të kujdesshëm në planifikime për shkak të afateve të kontratës në mes të NATO-s dhe HungaroControl-it (Organizatës Hungareze për gjegjëse momentalisht për ofrimin e Shërbimeve të Navigacionit Ajror në Hapësirën e lartë ajrore mbi Republikën e Kosovës) për menaxhimin e Hapësirës së Lartë Ajrore, e cila marrëveshje skadon në Prill të vitit 2019. Rrjedhimisht, nëse ASHNA nuk është e gatshme me gjithë infrastrukturën e nevojshme si dhe burimet njerëzore të domosdoshme për menaxhimin e hapësirës së lartë ajrore, mund të ndodhë që kjo mosgatishmëri të rezultojë që menaxhimi i hapësirës së lartë ajrore të Republikës së Kosovës t'i jepet HungaroControl-it apo një shteti tjetër për menaxhim gjatë një periudhe shtesë.

Nr.	BUXHETI KAPITAL 2018	
	Pasuria	Investimi 2018
1	Furnizim me kompjuterë dhe pajisje për sallën e mbledhjeve	55,000
2	Furnizim me pajisje për siguri të rrjetit me Firewall të Avancuar të Gjeneratës së Re (NGFW)	30,000
3	Sistemi i radio komunikimit	950,000
4	Sistemi i Survejimit	1,491,000
5	Inventar për Zyre	30,000
6	Objekti i Sigurimit në hyrje të parkingut	60,000
7	XRAY Scanner për bagazh	15,000
8	Makine për hapësirë manovruese dhe tereni.	25,000
9	pajisje për prodhimin e kartelave	15,000
10	Pjesë rezervë për MUXa në Golesh dhe ASHNA	8,000
11	Pjesë rezerve për sistemin e komunikimit tokë-tokë	7,500
12	Pjesë rezerve për sistemin VCR	20,000
13	Pjesë rezerve për sistemin AFTN	15,000
14	Pjesë rezerve për pajisjet e navigimit	40,000
15	Pjesë rezerve për PABX	10,000
16	Pjesë rezerve për PSR/MSSR mode M+S	250,000
17	Geotitan	6,500
18	Projekti në vazhdim "Furnizim me Sisteme të NAVIGIMIT dhe Rilokimi I Sistemeve ekzistuese"	372,000
Total		3,400,000

Mbi 600 nxënës vizituan ASHNA-në gjatë vitit 2017

Gjatë vitit 2017, Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA), me kënaqësi ka mirëpritur vizitat e mbi 600 nxënësve të shkollave dhe kopshteve të ndryshme si dhe të moshave të ndryshme.

Viteve të fundit është vërejtur një interesim i shtuar institucioneve arsimore të Republikës së Kosovës, kryesisht kopshteve të fëmijëve, institucioneve parashkollore e po ashtu edhe të shkollave fillore, që ta vizitojnë ASHNA-në si dhe të njihen më për së afërmi me natyrën e punës që zhvillohet në ASHNA.

Departamentet të cilat nxënësit kanë vizituar në ASHNA gjatë kësaj periudhe, kanë qenë varësisht prej moshës së tyre, mirëpo më shumë të interesuar kanë qenë për vizitën në Kullën e ASHNA-së, Departamentin Meteorologjik, si dhe Departamentin e Informatave Aeronautike.

Nxënësve ju është shpjeguar për mënyrën e funksionimit të ASHNA-së, përkatësisht punën e




Kontrollorëve të Trafikut Ajror si dhe mënyra e parashikimit të motit nga Departamenti Meteorologjik.

ASHNA, me kënaqësinë më të madhe mirëpret gjithnjë vizitat nga nxënësit e shkollave apo kopshteve të ndryshme, mirëpo paraprakisht duhet që të dërgohet kërkesë për vizitë në adresën elektronike: info.ashna@rks-gov.net.



Si drejtohet një fluturim sigurt nga Kontrollorët e Trafikut Ajror?



A e keni pyetur ndonjëherë veten teksa fluturoni me avion se si e di piloti se kah duhet të drejtoj avionin, duke e ditur faktin se dhjetëra ose qindra avionë u bien kryq e tërthor qiejve në të njëjtën kohë. Si ka mundësi që nuk përplasen?

Edhe pse këto pyetje i shqetësojnë me të drejtë udhëtarët, megjithatë, statistikisht tregojnë se fluturimi me avion është shumë i sigurt, madje më i sigurt se të udhëtosh me motoçikletë ose makinë. Një faktor i rëndësishëm i kësaj sigurie është sistemi i kontrollit të trafikut ajror. Kontrollorët e Trafikut Ajror drejtojnë

fluturimin tuaj të sigurt Kapiteni, ose piloti i parë, ka përgjegjësinë kryesore për sigurinë në avion. Megjithatë, ai nuk mund t'i shohë avionët e tjerë që fluturojnë rrotull, madje as nuk është i vetëdijshëm për praninë e tyre. Prandaj, ekziston sistemi për kontrollin e trafikut ajror. Një ekip punonjësish ndjekin nga toka çdo fazë të fluturimeve që bëhen sipas rregullave të fluturimit me ndihmën e kontrollit të trafikut ajror.

Kontrollorët e kontrollit ajror luajnë një rol jetësor për sigurinë e trafikut. Përparësia kryesore është të sigurojnë distancat midis avionëve. E para dhe më e

rëndësishmja është siguria, megjithatë, kontrollorët e trafikut ajror bëjnë të mundur edhe që trafiku të rrjedhë shpejt dhe me rregull. Pra, përveçse ndihmojnë për të shmangur përplasjet, kontrollorët e trafikut ajror sigurojnë edhe qarkullimin e avionëve.

E gjithë kjo do të thotë që, ndërsa piloti kujdeset për detyrat e veta në kabinën e pilotimit, fluturimin e ndjekin edhe shumë sy e veshë të tjerë nga toka. Piloti flet rregullisht me radio jo vetëm me kontrollorët e aeroporteve nga ku nisen dhe ku mbërrijnë avionët, por edhe me ata të pikave të ndryshme përgjatë fluturimit.

Në këtë epokë të avionëve me shpejtësi të lartë, është shumë e rëndësishme të mbash nën mbikëqyrje atë që piloti ende nuk mund ta shohë. Përfytyroni dy avionë udhëtarësh që po ndjekin një kurs që do t'i vinte ballë për ballë. Në çastin kur pilotët do ta dallonin njëri-tjetrin me sy të lirë, mund të kenë vetëm pak sekonda në dispozicion për të shmangur përplasjen! Pikërisht kontrolli i trafikut ajror ka përgjegjësinë që të parandalojë situata të tilla. Shumë kohë para se ta shohin njëri-tjetrin, pilotët kanë marrë udhëzime për të mbajtur një distancë sigurie.

(Vijon në faqen tjetër) →

(vijon nga faqja tjetër)

Radiotransmetues nga toka përcjellin sinjale për të drejtuar avionin. Piloti ka aparatura që kapin sinjalet e këtyre transmetuesve dhe i tregojnë me saktësi se ku ndodhet. Me që transmetuesit gjenden në pika të përcaktuara, avionët fluturojnë nga njëra pikë te tjetra derisa mbërrijnë në destinacion. Në fakt, këto pajisje ndihmëse fluturimi kanë krijuar rrugë ajrore të përcaktuara.

Kontrollorët e trafikut ajror i ndjekin avionët përgjatë këtyre rrugëve ajrore. Para se të nisen, pilotëve u kërkohet të dorëzojnë një plan fluturimi i cili tregon drejtimin që do të ndjekin. Kontrollorët kanë një kopje të atij që quhet shiriti i ecursisë së fluturimit. Përgjatë rrugëve ajrore ka pika kryqëzimi. Kur piloti fluturon mbi to, duhet t'ia raportojë këtë kontrollorit, i cili e

shënon te shiriti. Në këtë mënyrë, kontrollori ka një ide për rrugën që po ndjek avioni.

Për të marrë këto raporte, kontrollori ka edhe një mjet tjetër – radion. Ai e di se ku ndodhet avioni dhe i dërgon pilotit udhëzime që e ndihmojnë të mbajë një distancë sigurie nga avionët e tjerë. Kontrollorët dhe pilotët zakonisht kanë disa radio dhe frekuenca. Në rast se ndonjëra nuk punon, mund të përdorin një tjetër.

Ç'të themi për fluturimet ndërkombëtare, ku personeli flet gjuhë të ndryshme? Për të shmangur rreziqet që mund të vijnë nga keqkuptimet në komunikim, Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil ka zgjedhur anglishten si gjuhë të përbashkët të aviacionit. Gjithashtu, meqë disa fjalë, germa dhe numra tingëllojnë njësoj në radio,

kontrollorët e trafikut ajror mësojnë të përdorin fraza dhe shqiptime standarde kur u japin udhëzime pilotëve. Për të rritur edhe më tej shkallën e sigurisë, pilotëve u kërkohet të përsëritin disa udhëzime të kontrollorëve.

Një mjet tjetër që përdorin kontrollorët e trafikut ajror janë radarët. Valët e radios që përplasen me avionët kthehen pas dhe kapen nga antena e radarit. Avionët shfaqen si objekte ose shenja në ekranin e radarit të kontrollorëve. Shumë avionë janë të pajisur me një aparat urë e cila i transmeton antenës së radarit një sinjal identifikues. Kur ky sinjal bashkohet me të dhënat që gjenden në kompjuter, në ekranin e radarit shfaqet avioni, bashkë me numrin e fluturimit, shpejtësinë, lartësinë dhe me tipin e avionit.

Nëse e sheh të

nevojshme se avioni duhet të manovrojë për të parandaluar ndonjë përplasje, kontrollori ka disa mundësi veprimi.

Ai mund ta udhëzojë pilotin të ndryshojë: (1) kursin, ose drejtimin. Ky quhet ndryshe vektorizim. Ose mund ta udhëzojë të ndryshojë (2) shpejtësinë, në rast se një avion duket se po i afrohet një tjetri dhe mund ta parakalojë. Një mënyrë shumë e zakonshme se si ai i ndan avionët, është duke u ndryshuar (3) lartësinë. Shumë sisteme radarësh kanë edhe një veçori tjetër për të rritur sigurinë: ata mund t'i lajmërojnë kontrollorët kur lindin situata të rrezikshme. Për shembull, alarme pamore dhe dëgjimore ndizen nëse sistemi parashikon që dy avionë do të afrohen shumë me njëri-tjetrin. Një alarm tjetër ndizet nëse ndonjë avion duket se po i afrohet tepër sipërfaqes së tokës.

IMPRESSUM

Redaktor: Driton Ujkani

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Vrellë, Lypjan, 10070,
Republika e Kosovës
Tel: +381 (0) 38 59 58 641
E-mail: info.ashna@rks-gov.net
Web: www.anp-ka.org

